



Pranuar / Dorezuar Primjenol/Prodato Received/Delivery		09 - 10 2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKPMSTKK	6429	2023	119	



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1110/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Ardit Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1110/2023 të datës 24.08.2023 të ankueses nga Prishtina, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 06.10.2023, mori këtë.

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.1110/2023 e datës 24.08.2023 e parashtruara nga ankuesja.

A r s y e t i m

Ankuesja cili sipas shkresave të lëndës është kandidatë në procedurën e rekrutimit Specialistë të Arkitekturës pozita e punës "Zyrtar i Lartë për Planifikim dhe Zhvillim" dhe në procedurën e rekrutimit Specialistë të Arkitekturës pozita e punës "Zyrtar i Lartë për Arkitekturë", të shpallur nga Komuna e Prishtinës, me datë 30.01.2023 dhe datë 02.05.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokoll: 5797/2023 të regjistruar nën shenjen A.nr.1110/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se ka pasur vonesa të afateve kohore ndërmjet njoftimeve se e njëjta ka kaluar fazën paraprak dhe mbajtjes së testeve me arsyen se vonesat e tilla janë në kundërshtim me dispozitat e Udhëzimit nr.07/2017 për rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik e cila parasheh që ftesa për testin me shkrim duhet të bëhet të paktën 48 orë para mbajtjes së testit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, e ka proceduar

me datë 04.09.2023 kërkesën për përgjigje në ankesë te Komuna e Prishtinës. Ndërsa Këshilli me datë 08.09.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosjen e kësaj lënde, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 24.08.2023 të parashtruar në Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin e bashkangjitur dërguar nga Burimet Njerëzore për ankuesen me njoftimet e bashkangjitura për mbajtjen e testit me shkrim; Njoftimi për anulimin e testeve me shkrim; Kopjen e letërnjoftimit të ankueses; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 04.09.2023; Përgjigjen në kërkesë e datës 08.09.2023; Konkursin e datës 30.01.2023; Konkursin e datës 02.05.2023; Njoftimin e datës 09.03.2023; Njoftimin e datës 19.06.2023; E-mailin e datës 08.08.2023 dërguar nga Burimet Njerëzore dhe anasjelltas; E-mailin e datës 24.07.2023 dërguar nga Burimet Njerëzore; Aplikacionin e ankueses të datës 25.05.2023 me dokumentacionin e bashkangjitur.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankueses është e pa lejuar, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës ka gjetur se Komuna e Prishtinës me datë 30.01.2023 dhe datë 02.05.2023 ka bërë njoftimin publik për shpalljen e konkursit për pranim në procedurën e rekrutimit Specialistë të Arkitekturës RN00010876 pozita e punës "Zyrtar i Lartë për Planifikim dhe Zhvillim" dhe në procedurën e rekrutimit Specialistë të Arkitekturës RN00011579 pozita e punës "Zyrtar i Lartë për Arkitekturë", të shpallur nga Komuna e Prishtinës, ndërsa sipas njoftimit të datës 09.03.2023 dhe atij të datës 19.06.2023 është konstatuar fakti se në të dy pozitat e lartcekura ankuesja e ka kaluar fazën e verifikimit paraprak, gjegjësisht ka hyrë në listën e ngushtë me qëllim të nënshtrimit edhe në fazat e tjera të rekrutimit.

Lidhur me pretendimet e palës paditëse për vonesa, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore te Komunës së Prishtinës në përgjigjen e saj të datës 06.09.2023 ka deklaruar se vonesat e tilla kanë ardhur për shkak të probleme të vazhdueshme teknike në kuadër të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, respektivisht edhe në njoftimet të cilat i ka përcjellë Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore tek palët në procedurë përmes e-mailit të datës 24.07.2023 dhe 08.08.2023 kanë qenë të mbajtura në cc edhe Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik dhe po ashtu Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore ka marr njoftimin zyrtar përmes e-mailit të datës 26.07.2023 nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik se të njëjtit janë duke u përballur me probleme teknike madje në dy raste testet e mbajtura janë anuluar me njoftimin se të njëjtat do të ri përsëriten.

Kolegji i Këshillit me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankueses, ka analizuar dispozitat e Rregullore (QRK) nr. 16/2020 Për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës neni 1 dhe 2 paragrafi 1 ku përcaktohet se: "1. Kjo rregullore, ka për qëllim ndërtimin e një sistemi të qëndrueshëm dhe profesional për pranimin dhe avancimin në karrierë të nëpunësve civilë në pajtim me parimet themelore të Shërbimit Civil të përcaktuara në Ligjin nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë ( në tekstin në vijim LZP); 2.1. Kjo rregullore zbatohet për të gjithë shërbimin civil në Republikën e Kosovës, ajo përcakton procedurat për pranimin, lëvizjen brenda kategorisë dhe ngritjen në detyrë (avancimin) të nëpunësit civil" dhe ka ardhur në përfundimin se ankuesja iu ka referuar



gabimisht dispozitave të Udhëzimit nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, ngase i njëjti udhëzim nuk qenë zbatim në procedurat e rekrutimit për nëpunësit e Shërbimit Civil, respektivisht procedurat e pranimit në Shërbimin Civil janë të rregulluara dhe përcaktuara me Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 Për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës dhe Ligjin për Zyrtarët Publik.

Po ashtu, Kolegji i këshillit me qëllim të shqyrtimit të lejueshmërisë së ankesës së ankueses ka analizuar dispozitat e nenit 31 paragrafi 1, 2, 3 dhe 4 nën paragrafi 4.2 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës ku përcaktohet se: *“Kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil, i cili është i pakënaqur me vendimin e organit të punësimit, ka të drejtë të parashtojë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil (në vijim në tekstin e kësaj Rregullore “Këshilli”) . 2. Ankesa në Këshill parashtrohet vetëm pas shterimit të procedurës të brendshme të ankesës të organit përkatës që ka nxjerrë aktin apo kryer veprimin që kundërshtohet”,* andaj në këtë kuptim Kolegji vlerëson se kandidatët të cilët i nënshtrohen procedurave të rekrutimit për pranim në Shërbimin Civil, kanë të drejtë të parashtrorjnë ankesë në këshill, mirëpo me kushtin që paraprakisht të njëjtit t’i kenë shterur mjetet juridike për ankimim të brendshëm pranë organit që i zhvillon procedurat e brendshme, respektivisht tek Komisioni i Pranimit sikurse përcaktohet përshtatshmërisht edhe me nenin 25 paragrafi 6 të së njëjtës rregullore, ndërsa nga shkresat e lëndës si edhe nga pretendimet ankimore të ankueses por edhe nga përgjigja e Njesisë së Burimeve Njerëzore të Prishtinës, konstatohet fakti se ankuesja nuk ka parashtruar ankesë të brendshme paraprakisht sikurse përcaktohet me dispozitat e lartcekura.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit njëzëri konstaton se meqenëse ankuesja nuk ka ofruar asnjë dëshmi të provueshme se e njëjta pavarësisht parashtrimit të ankesës në Këshill të ketë parashtruar ankesë të brendshme ankimore tek organi që ka zhvilluar procedurën e rekrutimit, respektivisht tek Komisioni i Pranimit lidhur me pretendimet e saj për vonesa në fazën e testit me shkrim, ankesa e ankueses e rrethanat e rastit konkret është e palejueshme ngase nuk është plotësuar parakushti ligjor i përcaktuar me nenin 31 paragrafi 2 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës. Andaj, pas analizimit të shkresave të lëndës si dhe peshimit të secilës provë në procedurë të shqyrtimit të ankesës së ankuesit në mbështetje të nenit 16 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ku përcaktohet se: *“Para parashtrimit të ankesës në Këshill, nëpunësi civil apo kandidati i cili pretendon se është dëmtuar, duhet t’i ketë shteruar procedurat e brendshme të ankesave brenda organit përkatës të punësimit, nëse me ligj të veçantë nuk është përcaktuar ndryshe”* ankesa e ankueses vlerësohet të jetë e palejuar në këtë fazë të procedurës.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda me numër A.nr.1110/2023

Flakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

